



Prishtinë, 22 prill 2026  
ERO Kodi: V\_3147\_2026

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, Nenin 25 dhe Nenin 26 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të Ligjit (Nr. 05/L-084) për Rregullatorin e Energjisë dhe Nenin 23 paragrafi 7 të ligjit (Nr. 08/L-258) për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, Nenin 3 par. 2 nën par. 2.6 të Rregullës Nr. 01/2025 për Mekanizmin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme dhe Vendimin Nr. 08/236 të dt. 11.12.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e KOSTT SH.A., në kuadër të funksionit të Operatorit të Tregut, si subjekt përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme (OER),

në seancën e mbajtur më 22 prill 2026 nxori këtë:

**V E N D I M**

**MBI PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSIVE TË OPERATORIT TË ENERGJISË SË  
RIPËRTËRISHME (OER)**

- I. PËRCAKTOHEN - përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme (në tekstin e mëtejshëm: OER), si subjekt i caktuar për menaxhimin dhe operimin e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- II. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme (OER) është i obliguar të ushtrojë funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara me këtë Vendim në përputhje me Ligjin (Nr. 08/L-258), Rregullën Nr. 01/2025 dhe aktet ligjore dhe rregullative të nxjerra nga ZRRE.
- III. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme (OER) vepron si palë homologe ndaj prodhuesve të privilegjuar dhe kryen barazimin fizik dhe/ose financiar të energjisë nën mbështetje, duke përfshirë diferencat e pagueshme ndërmjet çmimit të fiksuar dhe çmimit referent për prodhuesit e privilegjuar sipas kontratave për diferencë (CfD), si dhe pagesat e premiumit për prodhuesit e privilegjuar sipas kontratave për premium. OER mbulon gjithashtu diferencat e pagueshme për prodhuesit që përfitojnë nga skemat me tarifa nxitëse dhe kompenson reduktimet e prodhimit në rastet kur këto reduktime i nënshtrohen kompensimit sipas skemave mbështetëse.



- IV. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme (OER) është përgjegjës për shitjen e energjisë elektrike në tregun e organizuar një ditë përpara, në përputhje me skemat mbështetëse dhe rregullat e tregut, duke përfshirë energjinë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e privilegjuar për të cilët mbështetja është dhënë para hyrjes në fuqi të skemave të reja mbështetëse, si dhe energjinë elektrike të prodhuar në bazë të Marrëveshjeve për Blerje të Energjisë (MBE) që nuk përmbajnë dispozita për konvertim në kontrata për diferencë.
- V. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme (OER) kryen barazimin e obligimeve financiare që rrjedhin nga Marrëveshjet për Blerje të Energjisë (MBE) të trashëguara, duke përfshirë skemat me tarifa nxitëse dhe mekanizmat me çmim referent, si dhe zbaton procesin e konvertimit të marrëveshjeve në Kontrata për Diferencë (CfD), në përputhje me Vendimet e ZRRE-së.
- VI. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme (OER) zbaton mekanizmin e kompensimit për vetë-konsumatorët e energjisë së ripërtërishme, si dhe zhvillon, mirëmban dhe publikon një regjistër publik të prodhuesve të energjisë nga burimet e ripërtërishme nën mbështetje, duke siguruar transparencë dhe përditësim të rregullt të të dhënave.
- VII. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme (OER) mbulon pjesërisht jo-balancet e shkaktuara nga prodhuesit e energjisë nga burimet e ripërtërishme nën mbështetje, duke përfshirë si prodhuesit e privilegjuar në kuadër të skemave mbështetëse ashtu edhe prodhuesit që operojnë në bazë të Marrëveshjeve për Blerje të Energjisë (MBE) të trashëguara, brenda marzhës së lejuar të gabimit dhe për një periudhë deri në dymbëdhjetë (12) muaj pas funksionalizimit dhe likuiditetit të tregut të organizuar një ditë përpara, në përputhje me skemat mbështetëse relevante, marrëveshjet në fuqi dhe rregullat e tregut.
- VIII. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme (OER) kërkon dhe administron instrumentet e sigurimit të pagesave nga furnizuesit, me qëllim të garantimit të stabilitetit financiar të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme.
- IX. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme (OER) ushtron këto përgjegjësi në përputhje me skemat mbështetëse të miratuara, aktet rregullative të ZRRE-së, dhe parimet e transparencës dhe mos-diskriminimit.

## Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji pas shqyrtimit të kornizës ligjore dhe rregullatore në fuqi që rregullon promovimin dhe mbështetjen e energjisë nga burimet e ripërtërishme në Republikën e Kosovës, vlerëson se është e nevojshme përcaktimi i qartë i përgjegjësive të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme (OER), me qëllim të sigurimit të funksionimit efikas, transparent dhe të qëndrueshëm të skemave mbështetëse.




- ZRRE vlerëson se Ligji Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë përcakton parimet dhe mekanizmat për mbështetjen e energjisë së ripërtërishme, duke përfshirë rolin e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme si subjekt kyç në administrimin e skemave mbështetëse dhe menaxhimin e marrëdhënieve financiare me prodhuesit e energjisë nga burimet e ripërtërishme. Mbi këtë bazë, OER ka rol thelbësor në garantimin e zbatimit të mekanizmave mbështetës në mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme financiarisht.
  - ZRRE vlerëson se Rregulla Nr. 01/2025 për Mekanizmin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme e miratuar nga ZRRE, përcakton në mënyrë të detajuar rolet dhe përgjegjësitë e OER, duke përfshirë menaxhimin dhe operimin e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme, veprimin si palë homologe ndaj prodhuesve të privilegjuar, administrimin e skemave mbështetëse, si dhe sigurimin e transparencës përmes regjistrimit publik dhe raportimit rregullator.
  - ZRRE, gjithashtu thekson se, në përputhje me Vendimin Nr. 08/236 dt. 11.12.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e KOSTT Sh.A., në kuadër të funksionit të Operatorit të Tregut, si subjekt përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme, është e domosdoshme që përgjegjësitë e këtij subjekti të operacionalizohen përmes një vendimi të veçantë të ZRRE-së, bazuar në legjislacionin në fuqi me qëllim të qartësimit të funksioneve dhe obligimeve të tij në zbatim të skemave mbështetëse.
  - ZRRE vlerëson se përcaktimi i qartë i përgjegjësive të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme (OER) kontribuon në rritjen e sigurisë juridike për të gjitha palët e përfshira në treg, në funksionimin efikas të tregut të energjisë elektrike, në veçanti të tregut të organizuar një ditë përpara, në garantimin e stabilitetit financiar të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme, në trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të prodhuesve të energjisë nga burimet e ripërtërishme, si dhe në lehtësimin e tranzicionit nga skemat e mëparshme mbështetëse drejt mekanizmave të rinj, në përputhje me zhvillimet e tregut dhe kornizën ligjore në fuqi.
  - ZRRE vlerëson se ky vendim siguron një ndarje të qartë ndërmjet skemave ekzistuese (MBE të trashëguara) dhe mekanizmave të rinj mbështetës (si kontratat për diferencë dhe premium), duke shmangur paqartësitë në interpretim dhe duke mundësuar një zbatim të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm të politikave energjetike.
  - Bordi i ZRRE-së, vlerëson se përcaktimi i përgjegjësive të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme (OER) është i domosdoshëm për të siguruar zbatimin efektiv të legjislacionit në fuqi dhe për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të energjisë së ripërtërishme në Republikën e Kosovës, andaj bazuar në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- X.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- XI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
\_\_\_\_\_

Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
\_\_\_\_\_


Lutfije Dervishi, Anëtare

  
\_\_\_\_\_

Gani Buçaj, Anëtar

  
\_\_\_\_\_

Arta Isufi, Anëtare

  
\_\_\_\_\_

Adnan Preniqi, Anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KOSTT SH.A.;
- KEDS SH.A.,
- Furnizuesve të licencuar dhe
- Arkivit të ZRRE-së.